



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:206009

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06365722

C.nr.3501/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit R.H. nga Mamusha, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 758.41 euro, me datë 29.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.H. nga Mamusha. **DETYROHET** e paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- Për periudhën kohore 10.04.2019 – 31.12. 2019, në shumën prej 107.46 euro;
- Për periudhën kohore 01.01.2020 – 28.02.2020, në shumën prej 1.76 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 109.22 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (07.10.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 758.41euro, përkatësisht shuma prej 649.19 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

DETYROHET e paditura Komuna e Mamushës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësi të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi R.H. nga Mamusha, me datë 07.10.2022, përmes të autorizuarit të tij Av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë. Në padi ka theksuar se paditësja është punëtore e arsimit pranë SHML "Ataturk" në Mamushë dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtresën e datës 19.12.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e padisë, duke theksuar se paditësi pagën bazë e ka në shumën prej 442.26 euro dhe i takon drejta në kompensim sipas inflacionit nga data 10.04.2019 deri me datën 07.10.2022, në shumë të përgjithshme prej 758.41 euro dhe atë, për vitin 2019 - $442.26 \times 2.7\% = 11.94$ euro për muaj $\times 9 = 107.46$ euro, për vitin 2020- $442.26 \times 0.2\% = 0.88$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 510.61$ euro, për vitin 2021 - $442.26 \times 3.4\% = 15.03$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 180.44$ euro dhe për vitin 2022 - $442.26 \times 11.6\% = 45.99$ euro për muaj $\times 10$ muaj $= 459.9$ euro.

E paditura Komuna e Mamushës - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.06.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendon paditësja nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës

shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Mamushës është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Për sa i përket pjesës së padisë për pagesën mbi bazën e inflacionit për vitin 2019, 2020, këto detyrime të pretenduara nga ana e palës paditëse kanë qenë në Kontratën Kolektive të vitit 2017 por kjo kontratë më nuk ka prodhuar efekt juridik pasi që në vitin 2021, është lidhur kontrata e re Kolektive 01/13 nr. prot 105 me datë 22.01.2021 ku në nenin 47 dispozitat kalimtare theksohet se: Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate nga palët shfuqizohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë në mes të MASHT dhe SBASHK nr.01B/2056, datë 18.04.2017, rrjedhimisht si e tillë nuk prodhon efekt juridik. Po ashtu, ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive e vitit 2017 janë parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar. Po ashtu, me parashtresën e datës 24.11.2023, e njëjta gjykatës ia ka bashkangjitur si provë Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.001/2020, të datës 21.01.2020, me të cilin vendim këtu paditësit i'u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak arritjes së moshës së pensionimit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 19.12.2022 si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës nr. protokollit 062/15 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Mamushës – Drejtoria e Arsimit, vërtetimi i datës 05.05.2022, për paditësin i lëshuar nga SHML “Ataturk” në Mamushë, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi ka qenë marrëdhënie pune tek e paditura në SHML “Ataturk” në Mamushë, si mësimdhënës nga periudha 01.09.2009, deri me 21.02.2020. Si dhe nga Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.001/2020, të datës 21.01.2020, me të cilin vendim këtu paditësit i'u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak arritjes së moshës së pensionimit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 442.26 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%,

për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 10.04.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 442.26 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 107.46 euro ($442.26 * 2.7\% = 11.94 * 9 = 107.46$);
- Për periudhën 01.01.2020-28.02.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 442.26 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 17.06 euro ($442.26 * 0.2\% = 0.88 * 2 = 1.76$);

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, Duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe se paditësi ka kërkuar që kompensimi në emër të inflacionit të realizohet në bazë prej 442.26 euro, për periudhën 10.04.2019, e deri më 07.10.2022. Nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.001/2020, të datës 21.01.2020, me të cilin vendim këtu paditësit i’u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak arritjes së moshës së pensionimit. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (10.10.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjykata pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditëses është parashkruar e gjeti të pa bazuar, pasi që me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 07.10.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.10.2019 e deri më 30.06.2022, gjykata konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin Tetor 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e Tetor 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht e njëjta atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e kualifikimit për muajin Tetor 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Nëntor 2019, e njëjta ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditësja nga fillimi i Nëntor 2019 ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e

paditësit për periudhën 01.10.2019 e deri më 30.06.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara dhe atë lidhur me precizimin e padisë në vlerës prej 104 euro, pasi që gjykata ka njohur shpenzimet për përpilimin e padisë e cila me paraqitjen e në gjykatës duhet të jetë e caktuar dhe e precizuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3501/22, me datë 29.10.2024

G j y q t a r i
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.